



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/86
Datë: 25.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Vendimin e Qeverisë nr. 04/49, të datës 29.05.2018, duke shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 2199/4, të datës 24.01.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i punës së vitit 2018 dhe Plani i veprimit të Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2019.
2. Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/86
Datë: 25.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën (GZ/Nr. 36/31 tetor 2016), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 05/49 datë 29.05.2018

1. Tërhiqet propozimi i Bordit Mbikëqyrës për Projekt-Statutin e Shoqërisë Aksionare "Trepça" Sh.A. i datës 17.05.2018.
2. Aprovohet plotësim-ndryshimi i propozimit të Bordit Mbikëqyrës për Projekt-Statutin e Shoqërisë Aksionare "Trepça" Sh.A.
3. Projekt-Statuti i Shoqërisë Aksionare "Trepça" Sh.A. nga pika 2. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/86
Datë: 25.01.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Shtetërore Kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit 2018-2022.
2. Koordinator Nacional për Strategjinë Shtetërore Kundër Krimit të Organizuar caktohet Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegojë te njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha institucionet tjera kompetente.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë